



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:180856

Datë: 17.12.2024

Numri i dokumentit: 06610817

CP.nr.38/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Divizioni Civil, e përbërë nga gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në lëndën përmbartimore të kreditorit E, me seli në Prishtinë, rr. “...”, kundër debitorëve: 1. S, me numër të regjistrimit të biznesit ..., me seli në Prizren, rr.”, 2. H.Ç, nga Prizreni, rr. “....”, dhe 3. E1, me seli në fshatin Dubravë, Komuna e Suharekës, me numër të regjistrimit të biznesit ..., lidhur me propozimin për përmbartim për shumën e borxhit në shumën prej 12,113.94 euro, gjykata jashtë seancës me datë 17.12.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET se është tërhequr propozimi për përmbartim i kreditorit E, me seli në Prishtinë.

II. PËRFUNDOHET procedura përmbartimore me shenjën, CP.nr.38/2024.

A r s y e t i m

Kreditori E, me seli në Prishtinë, me datë 12.11.2019 ka paraqitur propozimin përmbartimor ndaj debitorëve: 1. S, me numër të regjistrimit të biznesit ..., me seli në Prizren, rr. “.... 2. H.Ç, nga Prizreni, rr. “.... dhe 3. E1, me seli në fshatin Dubravë, Komuna e Suharekës, me numër të regjistrimit të biznesit ..., lidhur me përmbartimin e borxhit në shumën prej 12,113.94 euro.

Kreditori përmes parashtrësës së datës 16.12.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheq propozimin për përmbartim të datës 12.11.2019, me arsyetim se debitorët e kanë përmbushur obligimin ndaj kreditorit, si dhe këtë çështje e konsideron të mbyllur.

Në Ligjin për Procedurën Përmbartimore, në nenin 66 par. 4 përcaktohet “*Pas përmbushjes se kredisë se kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore*”.

Andaj gjykata në pajtim me dispozitat e nenit 261.3, 261.4, 387.1 pika c) të LPK-së lidhur me nenin 17 dhe 66 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

CP.nr.38/2024, datë 17.12.2024

B. Profesionale
Adelina Çmega

Gj y q t a r i
Berkan Hamza

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.